

GJYKTA THEMELORE MITROVICE (ne objektin e deges se kesaj gjykate ne Vushtrri); gjyqtari Skender Shala, me qeshtjen juridike kontestimore te paditeses nga ; te cilen e perfaqeson Av sipas autorizimit me shkrim ; kunder te paditures Komuna e , – Drejtoria per Arsim, per mospagesen e pagave percjellese me rastin e shkuarjes ne pension, pas nbajtjes se shqyrtimit kryesore, te mbajtur me dt. 11.02.2014, bie kete:

AKT GJYKIM

REFUZOHET kerkesepadia e paditises nga kunder te paditures Komuna e – Drejtoria per Arsim, per mospagesen e pagave percjellese me rastin e shkuarjes ne pension si e PA BAZUAR.

Secila pale I barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsy e t i m

Paditesja permes te autorizuarit te saj ka ushtruar padi ne kete gjykate kunder te paditures Komuna e – Drejtoria per Arsim, per mospagesen e pagave percjellese me rastin e shkuarjes ne pension.

I aurotizuari I paditises ne seancen e shqyrtimit kryesore dhe ne fjalen e tije perfundimtare theksoi se mbetet ne teresi prane kerkespadise dhe I propozoi gjykates ta aprovoi si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures konstestimore nuk I kerkoj

Perfaqesuesi I te paditures ne pergjigje te padise dhe kerkespadise se paditises theksoj se e kundershon kerkesepadine dhe kerkoj qe vendimi te mirret ne baze te rezultateve te provave .

Shpenzimet e procedures konstestimore nuk I kerkoj

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vleresimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-se erdhe ne perfundim se duhet te vendosur si ne dispozitiv te keti Aktgjykimit.



Gjykata ne proceduren e provave lexoi: Vendimin per pushimin e marredhenies te punes per shkak te plotesimit te kushteve per pension te pleqerise nr. te dt. 22.03.2010 leshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit KK njoftimin e Drejtorise Komunale te Arsimit ne te dt. 24.10.2012.

Pas analizimit dhe cmuarjes se provave te cekura nje nga nje dhe te gjitha se bashku si dhe rezultateve te tere procedures , gjykata e vleresoi se ne mes te paleve procedural nuk jane kontestuese keto fakte:

Se paditesja ka qene ne marredhenie pune te e paditura – ne Shkollen fillore te mesme te ulet “ ” ne e vend pune mesimedhenese.

Se paditeses marredhenia e punes eshte pushuar me arritjen e moshes se pleqerise 65 vjecare, pasi qe nje gje e tille konstatohet nga vendimi mbi pushimin e marredhenes se punes per shkak te plotesimit te kushteve per pension te pleqerise te cekur me larte.

Keto jane fakte te provuara me prova e te cilat nuk jane kontestuese per palet ndergjyqese. Kontestuese mbetet ceshtja e pageses se te ardhurave personale si dhe te ardhurave tjera si paga percjellese per shkak te shkuarjes ne pension.


Paditesja kerkesen e vet e mbeshtet ne Kondraten Kolektive konkretisht ne nenet 43 dhe 44.

Gjykata konsideron se ne rastin konkret kerkesadina e paditeses ne lidhje me pagat percjellese per shkak te shkuarjes ne pension eshte e PA BAZUAR per kete arsye:

Kontrata Kolektive ne te cilen bazohet kerkesa e paditeses nuk eshte ne fuqi qe nga viti 2008 , pasi kohezgjatja e kesaj kontrate ka qene per nje periudhe 3 vjecare.

Kjo specifikohet ne nenin 90.4 te Ligjit te Punes, ku ne menyre decitive thuhet: “Marreveshja Kolektive mund te lidhet per nje periudhe te caktuar me kohezgjatje jo me shume se tri (3) vjet”

Kontrata Kolektive ka hyre ne fuqi ne vitin 2005 ndersa qe nga viti 2008 sipas fuqise ligjore e njejta nuk prodhon kurrfare efekti juridik.



Andaj duke u bazuar ne te larte cekurat bazen ligjore te theksuar me larte dhe interpretimin e saj nga ana e gjykates , arrijme ne perfundim se kerkespadia e paditeses duhet te refuzohet ne teresi si e PA BAZUAR.

Nga te cekurat me larte e ne kuptim te nenit 143 te LPK-se u vendos si ne dispozitiv te ketije Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.281/12, te dt.11.02.2014.



KESHILLE JURIDIKE :Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 7 ditesh nga dita e pranimet, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimet e verteton: